



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.12/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Nesrin Lushta e Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve S.M nga P., V.G. nga P., M.S. dhe A.S. që të dy nga K., për shkak të veprave penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të Kodi Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), shtytje në ushtrimin e ndikimit nga neni 431 par.1 lidhur me nenin 32 të KPRK dhe dhënia e ryshfetit në tentativë nga neni 429 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.338/16 të datës 28.05.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.476/2018 të datës 23.10.2018, në seancën e mbajtur më datë 26.07.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

1. Me aprovimin e pjesshëm të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, konstatohet se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.338/16 i datës 28.05.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.476/2018 i datës 23.10.2018 janë marrë me shkelje të ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPPK në pjesën që i përket të pandehurit S.M për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK dhe të pandehurës V.G. për veprën penale shtytje në ushtrimin e ndikimit nga neni 431 par.1 lidhur me nenin 32 të KPRK.

2. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës e ushtruar kundër këtyre aktgjykimeve, në pjesën që ka të bëjë me të pandehurit V.G., M.S. dhe A.S., për veprën penale dhënia e ryshfetit në tentativë nga neni 429 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.338/16 të datës 28.05.2018. janë liruar nga akuza: i pandehuri S.M për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK, e pandehura V.G. për veprën penale shtytje në ushtrimin e ndikimit nga neni 431 par.1 lidhur me nenin 32 të KPRK dhe të pandehurit V.G., M.S. dhe A.S. për veprën penale në bashkëkryerje dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK. Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës dhe që paratë e konfiskuara në shumë prej 15.500 euro ti kthehen V.G.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës ka marrë aktgjykimin PAKR.nr.476/2018 e datës 23.10.2018 me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që shkeljet të konstatohen apo që lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- i pandehuri S.M., në të cilën ka paraqitur arsyet e veta nga të cilat konsideron se kërkesa nuk është e bazuar, duke potencuar posaçërisht se ndaj tij janë zhvilluar hetimet për dy vepra penale të keqpërdorimit të pozitës apo të autoritetit zyrtar dhe një veprë penale ushtrimi i ndikimit, por se aktakuza është ngritur për dy vepra penale të keqpërdorimit të pozitës apo të autoritetit zyrtar por jo edhe për veprën penale të ushtrimit të ndikimit, duke dhënë shpjegim se në këtë mënyrë akuza ka qenë juridikisht e paqëndrueshme siç ka qenë edhe procedura e cila ka vazhduar sipas kësaj aktakuze, ndërsa theksi tjetër ka qenë në atë se në rastin e F.D., paraburgimi ka qenë i stërzgatur dhe nuk ka pas asnjë parregullsi edhe po të kishte kërkuar shpejtimin e asaj procedure,

- mbrojtësi i të pandehurës V.G., avokati B.B. nga P. në të cilën ka shpjeguar se kërkesa nuk është e bazuar dhe ka propozuar që si e tillë të refuzohet me arsyetim se kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për të cilën bazë kërkesa me ligj nuk është e lejuar.

- i pandehuri A.S., i cili në kërkesë ka propozuar që kërkesa të refuzohet sepse qëllimi i tij nuk ka qenë dhënia e ryshfetit, një veprim eventual i këtillë nuk është vërtetuar por vetëm intenca e përgatitjes së të hollave nëse pranohet dorëzania.

Në përgjigjet është propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë aktgjykimin PML.nr.36/2019 të datës 05.06.2019 me të cilin pjesërisht është aprovuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës dhe është konstatuar se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.338/16 i datës 28.05.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.476/2018 i datës 23.10.2018 janë marrë me shkelje të ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPPK në pjesën që i përket të pandehurit S.M për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK dhe të pandehurës V.G. për veprën penale shtytje në ushtrimin e ndikimit nga neni 431 par.1 lidhur me nenin 32 të KPRK, ndërsa kërkesa është refuzuar si e pabazuar në pjesën që ka të bëjë me të pandehurit V.G., M.S. dhe A.S., për veprën penale dhënia e ryshfetit në tentativë nga neni 429 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me aktgjykimin nr. KI193/2019 të datës 31.12.2020 sipas kërkesës së të pandehurit S.M, me të cilin është konstatuar shkelja e nenit 31.1 (E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 (E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor) të KEDNJ-së e ka shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pml.nr.36/2019 të 5 qershorit 2019 duke e kthyer të njëjtin për rivendosje, në pajtueshmëri me Aktgjykimin e Gjykatës.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas këtij aktgjykimi, në procedurën e rivendosjes, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si dhe ato në përgjigjet e dhëna dhe konstatojë se:

- kërkesa është pjesërisht e bazuar.

1. Të pandehurit S.M dhe V.G.

Me rastin e shikimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimeve të kundërshtuara, e para se të vlerësojë pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme konstatojë se nga përmbajtja e aktgjykimit të shkallës së parë dhe atij të shkallës së dytë rezulton se disa fakte nuk kanë qenë kontestuese dhe ato do të elaborohen në vijim.

I pandehuri S.M në kohën kritike ka qenë kryetar i Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Në Gjykatën Themelore në Pejë ka qenë në zhvillim procedura penale kundër të akuzuarit F.D., për veprat penale shtytja në kryerjen e veprës penale vrasje e rënd dhe veprës penale vrasje në tentativë, ndërsa kundër vëllait të tij F.Gj. për veprën penale vrasje në tentativë. Në

procedurën e shkallës së dytë, me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.100/2013 të datës 26.11.2013 është anuluar aktgjykimi i shkallës së parë në këtë çështje penale dhe lënda është kthyer gjykatës së shkallës së parë-Gjykatës Themelore në Pejë, në rigjykim. Në mes tjerash është vendosur që ndaj F.D. të vazhdohet paraburgimi dhe është konstatuar se në mënyrë të kundërligjshme kjo procedurë është ndarë nga procedura penale kundër H.Gj., i cili në të njëjtën ngjarje ka qenë i akuzuar për veprën penale vrasje e rëndë dhe ndarja e procedurës ka ndikuar edhe në pamundësinë e vërtetimit të fakteve relevante, me sugjerim që në rigjykim të mbahet procedurë e bashkuar penale kundër të gjithë të emëruarve.

Ndaj të pandehurit M.S., në Gjykatën Themelore në Pejë ka qenë duke u zhvilluar procedurë penale për një vepër penale që lidhet me narkotikët dhe me këtë lëndë, sikurse edhe më lëndën paraprake, ka qenë e ngarkuar gjyqtarja L.M. Ai ka qenë në paraburgim dhe mirë është njohur me të pandehurën V.G..

E pandehura V.G. është bashkëshortja e F.D. Në fillimin e periudhës inkriminuese, ajo e ka kontaktuar të pandehurin S.M në zyrën e tij, për tu interesuar për lëndën e bashkëshortit, në të cilin paraburgimi ka qenë tejet i gjatë, por pastaj kontaktet në mes tyre kanë qenë të shpeshta sepse kanë hyrë në marrëdhënie intime.

I pandehuri S.M disa herë e ka kontaktuar gjyqtaren L.M., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Pejë e cila ka qenë e ngarkuar me lëndë, me të cilën ka biseduar edhe për këtë çështje.

Sipas gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë, këto fakte nuk kanë qenë kontestuese, por përfundimi i tyre ka qenë se kontaktet e këtilla e të pandehurit S.M me të pandehurën V.G. nuk kanë paraqitur vepër penale por shkelje të Kodit të etikës, ndërsa ato me gjyqtaren L.M. kanë qenë të lejuara për arsye se kryetari i Gjykatës së Apelit ka për detyrë të interesohet për lëndët në të cilat paraburgimi është i stërzgatur, në tërë gjykatat themelore të Kosovës.

Sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 pikat 1.1 dhe 1.2 lidhur me nenet 384 par.2 dhe 281 të KPPK dhe shkelje të ligjit penal.

Në kërkesë pretendohet se janë të gabuara konstatimet e lartcekura. E pandehura V.G. i ka ofruar shërbime seksuale të pandehurit S.M me të vetmin qëllim që ai nga pozita e vet, të ushtrojë ndikim të padrejtë te gjyqtarja L.M., në mënyrë që bashkëshorti i saj të ketë lehtësime në procedurën penale që zhvillohej ndaj tij. I pandehuri S.M, sipas kërkesës, duke e ditur se ka autoritet në gjykata si ekspert i lëmisë penale dhe si kryetar i Gjykatës së Apelit, ka ushtuar ndikim të padrejtë të gjyqtarja e rastit. Kjo ka rrjedhur nga takimet e shumta me gjyqtaren edhe në gjykatë edhe jashtë gjykatës dhe në kërkesë citohen pjesët e deklaratave të tyre të cekura në

aktgjykimet e kundërshtuara të cilat këtë e vërtetojnë. Thuhet se bisedat kryesisht kanë qenë rreth paraburgimit dhe se i pandehuri S.M e ka ditur se paraburgimi jo vetëm se ka qenë i vazhduar por nuk ka mundur të ndërpritet sepse Gjykata e Apelit në aktvendimin e lartcekur ka kërkuar bashkimin e procedurës në mes bashkëshortit të pandehurës V.G. dhe të akuzuarve tjerë në atë çështje, edhe pse njëri prej tyre ka qenë në arrati. Kontestohet se në veprimet e të pandehurit S.M ka vetëm elemente të shkeljes së Kodit të etikës e jo edhe të veprës penale për të cilën është akuzuar. Pretendohet se kishte për tu shkelur vetëm Kodi i etikës po të ekzistonin vetëm marrëdhëniet seksuale në mes të emëruarve, pa ndikim të gjyqtarja L.M. Nga të gjitha këto, duke iu shtuar edhe ca detaizime të cilat do të elaborohen në këtë aktgjykim, pretendohet se aktgjykimet në këtë pjesë kanë të meta ligjore të cilat paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal, të cilat duhet të konstatohen.

Gjykata Supreme gjeti se këto pretendime nuk janë të bazuara sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse aktgjykimet përmbajnë arsye ligjore për konstatimet e veta, por janë të bazuara sa i përket shkeljes së ligjit penal. Përkundër asaj që, siç theksohet edhe në përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurës V.G., ky mjet juridik konform dispozitës së nenit 432 par.2 të KPPK nuk lejohet për vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, kjo gjykatë të njëjtën e vlerësojë sepse ndërlidhej me shkeljen e pretenduar të ligjit penal. Siç do të përshkruhet më poshtë, u konstatua se në faktet e vërtetuara në mënyrë të drejt, gabimisht është aplikuar ligji penal në dobi të pandehurve S.M dhe V.G., sepse janë nxjerr përfundimet e gabuara për ekzistimin e veprave penale.

Së pari duhet të theksohet se në aktgjykimin e shkallës së dytë është konstatuar se në këtë çështje penale ndaj të pandehurit S.M *de facto* dhe *de jure* hetimet kanë pushuar. Kjo për arsye se ai fillimisht është ngarkuar për tri vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe një vepër penale të ushtrimit të ndikimit ndërsa, është akuzuar për dy vepra penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare por jo për veprën penale ushtrimi i ndikimit, e në procedurën e mëvonshme Gjykata e Apelit e ka hedhur akuzën për një vepër penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Në këtë situatë, ka ngelur vetëm një vepër penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare (e cila, me kualifikim tjetër juridik tani është objekt i shqyrtimit) por prokurori, në shqyrtimin gjyqësor, në fjalën përfundimtare e ka ndryshuar cilësimin juridik dhe ka gjetur se bëhet fjalë për veprën penale ushtrimi i ndikimit. Andaj, edhe pse hetimet formalisht nuk janë pushuar, i pandehuri nuk ka mundur të akuzohet për veprime të njëjta.

Në përgjigjen në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e të pandehurit S.M, në mënyrë më të detaizuar theksohet mu rrjedhja e këtillë e hetimeve e pastaj aktakuza e ngritur me pretendim se paraqet një parregullsi procedurale, për shkak të cilës nuk ka pas mundësi që eventualisht të shpallet fajtor për veprën penale nga aktakuza, për çka kërkesa është e pabazuar.

Gjykata Supreme gjeti se është i bazuar pretendimi në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë se ky konstatim në aktgjykimin e shkallës së dytë e as pretendimi në përgjigje e të pandehurit nuk mund të aprovohen.

Në këtë vend do të elaborohej përmbajtja e shkresave të lëndës sa i përket thënieve të cekura më lartë.

- Me aktvendimin për fillimin e hetimeve të Prokurorisë Themelore në Prishtinë PPS.nr.38/2015 të datës 20.07.2015. kundër të pandehurit S.M kanë filluar hetimet për dy vepra penale, njëra keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK dhe tjetra ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK.

Vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK ka pas të bëjë me dyshimin e arsyeshëm se (parafrazim) i pandehuri ka realizuar kontakte me V.G. të cilës i ka premtuar se do të ndikoj te gjyqtarja L.M. dhe do të siguroj dobi për bashkëshorten e V.G. F.D. dhe mikun e saj M.S., të cilët kanë qenë në paraburgim (më tutje “rasti V.G.”).

Vepra penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPK-së, ka pas të bëjë me dyshimin e arsyeshëm se i pandehuri ka ushtruar ndikim të padrejtë në veprimtarinë e gjyqtares L.M. lidhur me rastet në fjalë (më tutje “rasti L.M.”)

- Me aktvendimin për zgjerimin e hetimeve të njëjtës Prokurori PPS.nr.38/2015 të datës 28.07.2015 ndaj të pandehurit S.M janë zgjeruar hetimet për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka shfrytëzuar detyrën e tij zyrtare dhe autoritetin, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për A.M., në mënyre që më datën e pacaktuar në vitin 2014 në Klinë si dhe më datën 11.04.2015 në Kishën Katolike në Prishtinë, është takuar me të dëmtuarin P.G. dhe babën e tij Z.G. për t'iu kërkuar para në shumë prej 200.000 euro, të cilat P.G. kinse i ka pas borxh A.M., vepër kjo e cilësuar si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK (më tutje “rasti i Kishës”).

- Me aktakuzën e Prokurorit Special të Kosovës PPS.nr.38/2015 të datës 30.05.2016 i pandehuri S.M është akuzuar për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPK, në të cilën janë fuzionuar "rasti V.G." dhe rasti “L.M.”, që do të thotë se ai është akuzuar për kontaktet me V.G. për të siguruar favore në procedurë për F.D. dhe M.S. dhe për ndikimin në punën e L.M.

Me këtë aktakuzë është akuzuar edhe për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPRK, për “rastin Kisha”, por gjatë procedurës së mëtutjeshme, me aktvendimin e formës së prerë të gjykatës së shkallës së parë PKR.nr.338/16 të datës

11.07.2017 akuza është hedhur. Andaj, kjo vepër penale ma nuk ka qenë objekt i shqyrtimit gjatë shqyrtimit gjyqësor e as tani.

Nga kjo rrjedh se objekt i shqyrtimit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qenë një vepër penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 të KPK në përshkrimin e së cilës kanë qenë “rasti V.G.” dhe “rasti L.M.” si një vepër penale në vend të dy veprave të cilat gjatë hetimeve kanë qenë të ndara, e të cilat më lartë u përshkruan. Kjo gjykatë konstatojë se qëllimi i hetimeve edhe ka qenë sqarimi i fakteve të rëndësishme për veprën penale dhe ekzekutorin dhe aktakuza i përshtatet gjetjeve që rrjedhin pasi që hetimet përfundojnë.

Është më rëndësi të theksohet se përmbajtja e aktakuzës për këtë vepër penale gjegjësisht përshkrimi i veprimeve inkriminuese që i janë vënë në barë të pandehurit, janë ato të njëjta sikur në fazën e zhvillimit të hetimeve dhe nga kjo akuzë ose përshkrimi i veprimeve konkrete, prokurori asnjë herë nuk ka hequr dorë, por në fjalën përfundimtare tërë ngjarjen juridikisht e ka cilësuar ndryshe-si vepër penale ushtrimi i ndikimi nga neni 431 par.1 të KPRK.

Këtu së pari duhet të theksohet se nuk është e bazuar gjetja e gjykatës së shkallës së dytë e as pretendimi në përgjigjen e të pandehurit S.M në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, se pasi nuk është ngritur aktakuza për “rastin L.M.” gjegjësisht për veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPPK, hetimi ka pushuar me kalimin kohor të afatit nga neni 159 të KPPK gjegjësisht për këtë ngjarje nuk ka mundur të mbahet shqyrtimi gjyqësor. Kjo për arsye se as de facto as de iure prokurori nuk ka hjek dorë nga ndjekja penale për këtë vepër penale, ose në mënyrë më precize, për veprimet konkrete inkriminuese e të pandehurit, sepse ato i ka bashkuar me “rastin V.G.”.

Së dyti, sipas theksimeve në përgjigjen e të pandehurit S.M, prokurori, me rastin e ndryshimit të aktakuzës në shqyrtimin gjyqësor i ka tejkalluar autorizimet e veta që i jep dispozita e nenit 350 par.1 të KPPK, ku thuhet se “Kur prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, ai në shqyrtimin gjyqësor mund ta ndryshojë aktakuzën gojarisht dhe mund të propozoj që shqyrtimi gjyqësor të ndërpritet për përgatitjen e aktakuzës së re”. Kjo në rastin konkret nuk ka ndodhur.

Gjykata Supreme konstatojë se në rastin konkret aktakuza nuk është ndryshuar.

Prokurori i shtetit nuk ka ndryshuar asnjë fakte nga përshkrimi faktik i veprimeve të pandehurit nga aktakuza.

Ajo çka ka ndodhur është se prokurori i shtetit, në bazë të provave të nxjerra, ndryshe i ka cilësuar veprimet e të pandehurit dhe e ka ricilësuar veprën penale nga vepra penale

keqpërdorimi i detyrës zyrtare nga neni 422 të KPRK në veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 431 par.1 të KPRK, që ka qenë e drejtë e tij, sepse ai disponon me akuzën e vet dhe kjo në praktikën gjyqësore ndodhë shumë herë. Për më tepër, konform dispozitës së nenit 360 par.2 të KPPK, gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës, por është e lidhur vetëm me përshkrimin faktik të saj.

Nga këto arsye nuk u aprovuan të cekurat në përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në këtë drejtim e njëkohësisht as gjetjet të gjykatës së shkallës së dytë që ndërlihen me ato.

Gjykata Supreme më tutje konstaton se gjykata e shkallës së parë, e posaçërisht ajo e shkallës së dytë, kanë bërë ndarjen e veprimeve të pandehurit S.M, në kontaktet me të pandehurën V.G. dhe kontaktet e tij me gjyqtaren-dëshmitaren L.M. Në ato bëhet shumë pak fjalë për marrëdhëniet intime në mes të pandehurve S.M dhe V.G.. Megjithatë, ato nuk kanë qenë kontestuese sepse gjykata ka disponuar me përgjimet të bisedave telefonike dhe fotografitë të dërguara nga telefonat mobil, të cilat janë nxjerr si provë në shqyrtimin gjyqësor dhe aktgjykimet bazohet edhe në këto prova. Mirëpo, aktgjykimeve iu mungon ndërlihdja e përmbajtjes së bisedave të përgjuara në mes të pandehurve S.M dhe V.G., me kontaktet e të pandehurit S.M, me gjyqtaren L.M. Në anën tjetër, kontaktet e fundit jo vetëm se janë konstatuar, por përmbajtja e tyre është analizuar. Me këtë rast, gjykatat kanë gjetur se në periudhën inkriminuese i pandehuri S.M disa herë është takuar me gjyqtaren L.M. Takimet kanë qenë në Gjykatën Themelore në Pejë por edhe në restorantin “Bistro” në Prishtinë. Bisedat kryesisht kanë qenë rreth problemeve në zgjedhjen e lëndëve me paraburgim por edhe për përshpejtimin e çështjes së F.D. Duke i vlerësuar këto fakte, gjykatat kanë gjetur se i pandehuri S.M, si kryetar i Gjykatës së Apelit ka ndërmarr veprime të ligjshme, sepse lëndët me paraburgim janë të natyrës urgjente dhe i pandehuri, duke qenë në këtë cilësi, detyrohet që të kërkojë nga gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore në Kosovë që sa më shpejt ta procedojnë. Gjykata e Apelit në aktgjykimin e vet ka theksuar se ka qenë veprim i ligjshëm i të pandehurit S.M, që ka kërkuar nga gjyqtarja që çështja e F.D. të veçohet dhe të procedohet veçmas, sepse në rast të bashkëkryerjes, e kur ndonjëri prej të akuzuarve ndodhet në arrati, lënda duhet të veçohet për atë të akuzuar i cili është në paraburgim, pa marrë parasysh se në vendimin e asaj gjykate PAKR.nr.100/2013 të datës 26.11.2013 është kërkuar e kundërta-që lënda të bashkohet për të gjithë të akuzuarit.

Duke i vlerësuar këto konstatime lidhur me pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme konstaton se nga përgjimet e bisedave telefonike vërtetohet se të pandehurit S.M dhe V.G., së paku një herë kanë biseduar për atë se i pandehuri S.M do të takohet me gjyqtaren L.M. (në restorantin “Bistro” në Prishtinë). Kjo tregon se takimi ka qenë paraprakisht i caktuar, ekskluzivisht për ta biseduar çështjen e F.D. Nga përgjimet rezultojnë këto biseda: më datën 02.07.2015 e pandehura V.G. e ka pyetur të pandehurin S.M se a ka qenë të gjyqtarja (duke mos ia përmendur emrin) dhe ai i është përgjigjur se “po, kam qenë, qysh

qatëher kur kam qenë në Istog” dhe në pyetjen e saj se për se nuk i ka treguar, ai është përgjigjur se “duhet të sheh-të takohen, për ti treguar”. Më datën 16.07.2015 i pandehuri S.M e ka ftuar me telefon gjyqtaren L.M. duke e pyetur se kur i kryen punët e veta, për tu takuar, ndërsa ajo i ka treguar se është duke ardhur në Prishtinë, se deri në ora 13:00 ka takim tek “Demokracia në veprim” dhe mund të takohen pas orës 13:00 dhe ai ka thënë që atëherë të takohen në qytet. Një ditë më parë, më datën 15.07.2015 i pandehuri S.M i ka treguar të pandehurës V.G. se të nesërmen, më datën 16.07.2015 do të takohet me gjyqtaren e pastaj do të takohet me V.G. dhe “do ti tregojë si ka shkuar takimi dhe se çka ka mundur të bëjë”. Në bisedën e datës 16.07.2015 i pandehuri S.M i ka treguar të pandehurës V.G., se “nuk është keq por nuk mund të përshpejtohet shumë, se ka pengesa” dhe se “ka pengesa se nuk po mundet me i bo bashkë këta që duhet me i bo bashkë” se “ajo-gjyqtarja do të shkojë në pushim, por vetëm një javë...shihemi e flasim”, e në pyetjen e të pandehurës V.G. se gjyqtarja a e ka pritur mirë, përgjigjet se “po”.

Gjykatat vendimet e veta e kanë bazuar edhe në këtë provë, që do të thotë se përmbajtja e këtyre bisedave nuk është kontestuar. Megjithatë, kanë nxjerr konkludim të gabuar se e gjithë ajo që ka të bëjë me kontaktet në mes të pandehurve S.M dhe V.G., tërësisht duhet të shikohet ndaras, të trajtohet vetëm si shkelje e Kodit të etikës, e jo të ndërlihet me veprimet tjera inkriminuese që iu vihen në barë të pandehurve-ushtrimin e ndikimit.

Gjykata Supreme konstatojë se qartazi shihet se bisedat e të pandehurit S.M dalin nga sfera profesionale dhe bisedat me gjyqtaren e marrin një karakter tjetër sepse për ato njoftohet edhe e pandehura V.G., e cila është tejet e interesuar për çështjen. Në bisedat telefonike ajo informohet shkurtimisht dhe bisedat më të gjërësishme lihen të behën në takimet personale.

Më lartë u theksua se sipas arsyeve të dhëna në aktgjykimet e kundërshtuara, pasi që lëndët me paraburgim janë të natyrës urgjente, i pandehuri, duke qenë në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Apelit, detyrohet që të kërkojë nga gjyqtarët e të gjitha gjykatave themelore në Kosovë që sa më shpejt ta procedojnë në këto lëndë.

Gjykata Supreme me kujdes e vlerësojë këtë gjetje dhe gjeti se është e gabuar dhe se kërkesa edhe në këtë pjesë është e bazuar. Në Rregulloren mbi organizimin e brendshëm të gjykatave, e cila është marrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datën 04.01.2013 bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Ligjin për gjykatat, në nenin 4, ku përcaktohen përgjegjësitë e kryetarit të gjykatës, gjithnjë bëhet fjalë për përgjegjësitë e tij brenda gjykatës së vet dhe nuk ka dispozitë e cila kryetarit të Gjykatës së Apelit i jep kompetenca për të gjitha gjykatat tjera në Kosovë. Si shembull janë këto kompetenca: drejtimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë, organizimit dhe aktiviteteve të administratës gjyqësore të gjykatës në baza ditore, në harmoni me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme; autorizimi i procedurave të punësimit dhe procedurat disiplinore të personelit jo gjyqësor; sigurimi i administrimit gjyqësor efikas dhe efektiv mbi degët, departamentet dhe divizionet e gjykatës; caktimi dhe ricaktimi i gjyqtarëve në

departamentet dhe divizionet përkatëse duke u bazuar në kualifikimet e tyre për të siguruar gjykimin efikas të lëndëve etj. Andaj, është i pambështetur vlerësimi i dhënë në aktgjykimin e shkallës së dytë se i pandehuri, si kryetar i Gjykatës së Apelit ka kompetenca jashtë gjykatës së vetë, në gjykatat në tërë territorin e Kosovës.

Në anën tjetër, komunikimet me palët apo personat tjerë nga ana e kryetarit të gjykatës por edhe nga gjyqtarët, bëhen konform ligjit, me shkrim apo me konstatim në shënimin zyrtar, që në rastin konkret ka munguar. Takimi në restorantin “Bistro” po ashtu është indikativ, sepse është caktuar dhe mbajtur, ekskluzivisht për të biseduar çështjen e bashkëshortit të pandehurës V.G.

Gjykata Supreme për këto arsye i konsiderojë të pabazuara pretendimet në përgjigjen e të pandehurit S.M ku kishte arsyetuar veprimet e veta si veprime të ligjshme, për shkak të stërzgjatjes së paraburgimit në rastin e F.D.

Çështja tjetër e cila drejtë është vërtetuar por nuk është vlerësuar në mënyrë ligjore, është se takimet me gjyqtaren e cila ka qenë e ngarkuar me lëndë, kanë qenë të shpeshta dhe pa dyshim në ato është diskutuar edhe çështja e F.D. Kjo vërtetohet edhe nga deklarata e dëshmitares L.M. e cila ka thënë se në atë kohë ka pas vetëm dy lëndë të rënda me paraburgim-të F.D. dhe M.S. Andaj, i pandehuri S.M jo vetëm një herë e ka potencuar këtë çështje te gjyqtarja e rastit, që do të thotë se ka shprehur interesim i cili del nga kufijtë e një komunikimi zyrtar dhe profesional.

Ajo çka rrjedhe nga mbrojtja e të pandehurit S.M dhe dëshmia e gjyqtares L.M. është se i pari i ka thënë se ajo “ka përgjegjësi rreth zgjatjes së paraburgimit” dhe i ka sugjeruar që të trajtojë mundësinë e veçimit të procedurës ndaj F.D., si dhe se pala (e pandehura V.G.) i ka ardhur në zyre për këtë çështje dhe i ka premtuar se do ta bëjë të pamundurën për caktimin e shqyrtimit në rigjykim, “të ketë kujdes sepse i pandehuri F. është një kohë të gjatë në paraburgim”, siç ka thënë gjyqtarja.

Gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar se kjo nuk paraqet ndikim të paligjshëm, siç nuk është i vërtet as fakti se i pandehuri S.M, ka kërkuar ricilësimin e veprës penale me të cilën ka qenë i ngarkuar F.D. Mirëpo, Gjykata Supreme konstatojë se i pandehuri S.M nuk ka qenë i akuzuar për ndikim për tu ndryshuar cilësimi juridik i veprës penale të F.D., por vetëm për përshpejtimin e zgjidhjes së lëndës-caktimit të shqyrtimit gjyqësor, siç me të drejt ceket në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë në aktgjykimet e veta në mënyrë të drejt dhe të plotë kanë vërtetuar faktet vendimtare të çështjes konkrete por me lirimin e të pandehurve kanë nxjerr përfundimeve të gabuara për ekzistimin e veprës penale, që paraqet shkelje të ligjit penal nga neni 385 pika 4 të KPPK-kanë aplikuar ligjin i cili nuk ka mundur të aplikohet, sepse me aplikimin e drejt të ligjit penal ai duhej të shpallej fajtor për veprën që është

objekt i akuzës. Se veprimet e tij paraqesin ushtrim të ndikimit rezulton nga të gjitha faktet të cekura më lartë. Së pari, shkas për bisedat me gjyqtaren, ka qenë lidhja intime me V.G., e cila nuk ka ekzistuar më parë por ka ndodhur pasi ajo ka ardhur për tu interesuar për lëndën e bashkëshortit. Pa iniciativën e saj, i pandehuri S.M nuk ka filluar bisedat me gjyqtaren, së paku nga provat e nxjerra nuk del se më parë, ka filluar këto biseda. Me fillimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve intime në mes tyre, shpeshohen takimet me gjyqtaren dhe nga përgjimet e bisedave telefonike del se së paku dy herë i pandehuri S.M e ka informuar të pandehurën V.G. për bisedën me gjyqtaren dhe për atë se “çka ka mundur të bëjë”. Së dyti, qëndrimi në paraburgim i F.D. është ngushtë i ndërlidhur me vendimin të cilin e ka marrë Gjykata e Apelit. Kjo gjykatë me aktvendimin PAKR.nr.100/2013 të datës 26.11.2013 ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë në këtë çështje penale dhe lënda është kthyer gjykatës së shkallës së parë-Gjykatës Themelore në Pejë në rigjykim, e me të cilin në mes tjerash është vendosur që ndaj F.D. të vazhdohet paraburgimi dhe është konstatuar se në mënyrë të kundërligjshme kjo procedurë është ndarë nga procedura penale kundër H.Gj., i cili në të njëjtën ngjarje ka qenë i akuzuar për veprën penale vrasje e rënd, që ka ndikuar edhe në mos mundësinë e vërtetimit të fakteve relevante, me sugjerim që në rigjykim të mbahet procedurë e bashkuar penale kundër të gjithë të emëruarve. Me fjalë tjera, Gjykata e Apelit ka konstatuar se prania e të gjithë të akuzuarve në atë çështje penale, rrjedhimisht bashkimi i procedurës, është kusht për vërtetimin e drejt të gjendjes faktike. Andaj, gjykata e shkallës së parë-Gjykata Themelore në Pejë, ka qenë e lidhur me këtë aktvendim, i akuzuari H.Gj. ka qenë arrati dhe kjo ka qenë pengesë objektive edhe për shkurtimin e zgjatjes së paraburgimit të pandehurit F.D. I pandehuri S.M si person me kualifikim të lartë profesional, i ka ditur këto fakte. Edhe pse ka ditur se gjyqtarja i ka “duart e lidhura” disa herë i ka bërë me dije se “mbanë përgjegjësi për paraburgim”. Gjykata Supreme konstaton se gjyqtari konstatimet e veta i jep në vendimet e veta dhe është jo ligjore që i pandehuri i ka sugjeruar gjyqtares që të bisedojë me kryetarin e kolegjit në Gjykatën e Apelit i cili e ka marrë aktvendimin në fjalë. Edhe pse ky veprim nuk është objekt i akuzës, këtë e ka deklaruar gjyqtarja në fjalë dhe kjo e përforcojë bindjen e kësaj gjykate për angazhimin jo profesional dhe kundërligjor e të pandehurit S.M rreth kësaj çështje. Fakti se nuk ka pasur sukses gjegjësisht ndikimi nuk ka arritur rezultatin e synuar (edhe vet i ka thënë të pandehurës V.G. se “ka pengesa”) nuk e ndryshon pozitën juridiko penale e të pandehurit, siç parashihet me dispozitën e nenit 431 par.1 të KPK.

Këto konstatime të Gjykatës Supreme për pjesët e aktgjykimeve të kundërshtuara për të pandehurin S.M, në shumë vende i kanë përfshirë edhe gjetjet për të pandehurën V.G. për veprën penale për të cilën ka qenë e akuzuar.

Duke e arsyetuar vërtetimin e aktgjykimit lirues, gjykata e shkallës së dytë në faqen 8 në pasusin 2 ka thënë se shtytja në kryerjen e veprës penale kryhet në dy forma: 1) duke ndikuar që kryesi të merr vendim për kryerjen e veprës penale dhe 2) kur kryesi ka marrë vendim për të kryer veprën penale por akoma hamendet dhe shtytësi ia forcon këtë vendim, por se i pandehuri

S.M asnjëherë nuk ka deklaruar se të pandehurit V.G. dhe M.S. kanë vepruar kështu. Gjykata Supreme konstatojë se i pandehuri M.S. as që ka qenë i akuzuar për këtë veprë penale, ndërsa sa i përket përgjimeve të bisedave telefonike në mes tij dhe të pandehurës V.G. kanë ngelur pa një vlerësim, gjegjësisht edhe këtu në faktet drejt të vërtetuara gabimisht është aplikuar ligji penal. Në këtë vend do të citohen vetëm disa pjesë të përgjimeve të bisedave telefonike lidhur me këtë fakt. Më datën 15.03.2015, e pandehura V.G. i ka treguar të pandehurit M.S. se i pandehuri S.M i ka treguar se “punën e parë ka me hjek sto posto (vërejtje e kësaj gjykate se kjo do të thotë `qind për qind`), ...”, me datën 16.03.2015 dhe 25.03.2015 se i pandehuri S.M i ka treguar se ka folur me gjyqtaren gjegjësisht se ka shkuar disa herë te gjyqtarja dhe i ka treguar se “çka me bo”. Me datën 11.04.2015 përgjimet kanë treguar se i pandehuri S.M i thënë se “secilin send qe e punojnë, gjyqtarët vijnë te ai dhe ai e kryen, se e ka shkruajt emrin e mbiemrin e të pandehurit M.S. në letër, “se po harojke”; më 25.06.2015 e pandehura V.G. në bisedë telefonike i ka treguar bashkëshortit të saj F.D. se “sot do te dal me herët se do te takohet me atë (pason një fjalë ofenduese”); më datën 15.07.2015 e pandehura V.G. i ka treguar të pandehurit S.M se çka ka biseduar me avokatin e bashkëshortit, avokatin H.Q. Andaj, me të drejt pretendohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë se shkuarja e të pandehurës V.G. në zyrën e të pandehurit S.M, hyrja në marrëdhënie seksuale, këto biseda telefonike, tregojnë se për të arritur qëllimin e vet, ajo e ka shtytë të pandehurin S.M në kryerjen e veprës penale për të cilën ka qenë i akuzuar dhe kjo shtytje nuk ka qenë vetëm për çështjen e F.D. por edhe për atë të M.S.

Theksimet në përgjigjen në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurës V.G. për jo bazueshmërinë e të gjitha pretendimeve të kërkesës, në pjesën që ka të bëjë me këtë pjesë të aktgjykimit, e nga shkaqet e cekura më lartë, u konsideruan si të pabazuara.

Nga këto shkaqe, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar sa i përket shkeljes së ligjit penal në dobi të pandehurve S.M dhe V.G. dhe kjo shkelje nga neni 385 pika 4 të KPPK gjegjësisht aplikimi i ligjit i cili nuk ka mundur të aplikohet, u konstatua dhe u maur vendimi nën pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 438 par.1.3 të KPPK.

2. Të pandehurit V.G., M.S. dhe A.S.

Të pandehurit V.G., M.S. dhe A.S. janë liruar nga akuza për veprën penale dhënia e ryshfetit në tentativë nga neni 429 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPK dhe përshkrimi i veprimeve inkriminuese në aktakuzë ka qenë se, sipas marrëveshjes paraprake, më 20.02.2015. e pandehura V.G. ka marrë nga i pandehuri A.S. para në shumë prej 20.000 euro, të cilat ka pasur për ti dhënë zyrtarit S.M, me qëllim të lirimit nga paraburgimi të pandehurve M.S. dhe F.D., për veprat penale për të cilat ndaj tyre ka qenë duke u zhvilluar procedurë penale në Gjykatën Themelore në Pejë.

Të emëruarit janë liruar nga akuza me aktgjykimet e kundërshtuara dhe në këtë pjesë, këto aktgjykime nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as me shkelje të ligjit penal, të cilat pa bazë pretendohen në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë janë se nga përgjimet e bisedave telefonike është vërtetuar se i pandehuri M.S., nga paraburgimi i ka thënë babait të vet A.S. që t'ia jap shumën e parave prej 20.000 euro të pandehurës V.G., se ashtu edhe është vepruar, e pandehura V.G. i ka treguar të pandehurit M.S. se paratë i mbanë në tavolinë, se kauçi i babait të saj është i mbushur me para, se i pandehuri S. ato i ka pa e, për më tepër i ka marrë, se si provë është administruar fotografia nga telefoni i saj në të cilën ajo paraqitet me bankënota prej 500 euro të palosura në formë të flladitëses dhe se nga e gjithë kjo rrjedh se e pandehura i ka pranuar paratë nga të pandehurit A. dhe M.S., me qëllim të dhënies së ryshfetit zyrtarit S.M. Në kërkesë pretendohet se duke i marrë parasysh këto prova, me lirimin e tyre nga akuza në dobi të tyre është shkelur ligji sepse do të duhej të shpallehin fajtor dhe se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1.3 lidhur me nenin 281 të KPPK.

Duke i vlerësuar këto pretendime, bashkë me përmbajtjen e përgjigjeve të mbrojtësit të pandehurës V.G. dhe të pandehurit A.S., e pas shikimit të aktgjykimeve të kundërshtuara dhe të shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se faktet relevante janë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë sepse dhënia e parave të pandehurës V.G. nga i pandehuri A.S. e në kërkesën e të pandehurit M.S., nuk ishte kontestuese siç nuk ka qenë kontestuese se qëllimi ishte dhënia e tyre të pandehurit S.M si ryshfet. Arsyet për lirimin e tyre nga akuza në që të dy aktgjykimet janë të qarta dhe ligjore, të bazuara në vlerësimin e provave siç kërkohet me dispozitën e nenit 361 par.2 të KPPK. Në aktgjykimin e shkallës së parë, në faqen 21 është konstatuar se nuk është vërtetuar se e pandehura V.G. ia ka premtuar ose dhënë këto të holla të pandehurit S.M dhe se ajo nuk e ka cilësinë e personit zyrtar, që është kusht për ekzistimin e kësaj veprë penale. Me të drejt ceket në kërkesë se vetia e personit zyrtar nuk kërkohet për personin i cili e jep ryshfetin, mirëpo, sipas vlerësimit të kësaj gjykate edhe pa këtë element, do të merrej aktgjykim lirues. Në aktgjykimin e shkallës së dytë, në faqen 8 në paragrafin e fundit, është cekur se në asnjë bisedë telefonike nuk është përmendur tentimi i të pandehurës V.G. (si person i vetëm i cili drejtë për së drejti ka komunikuar me të pandehurin S.M) ose të personave tjerë të pandehur, për ti dhënë paratë të pandehurit S.M. Gjykata Supreme konstatojë se lidhur me këto para të pandehurit M.S. dhe V.G. kanë pas biseda jashtëzakonisht të shumta, por vërtet në asnjë bisedë me të pandehurin S.M ato nuk janë përmendur, e as që e pandehura V.G. eventualisht i ka thënë të pandehurit M.S. se ka pas tentim për ofrimin e parave të pandehurit S.M. Përkundrazi, ajo gjithnjë ka shprehur hezitim dhe pasiguri. Fakti i cekur në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë se ekziston një fotografi në të cilën e pandehura V.G. shihet me të holla në bankënota prej 500 euro, nuk ndryshon asgjë sepse gjykata duhet të disponoj me prova bindëse për secilin element të veprës penale, që në rastin konkret ka munguar. Gjykata Supreme konstatojë se sipas dispozitës së nenit 28 par.1 të KPK, kushdo që me dashje ndërmerr veprimet për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer

ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryerje vepër penale. Andaj, për të ekzistuar tentativa, veprimi i kryerjes së veprës penale duhet të ndërmerret, por të jetë i pasuksesshëm, që në rastin konkret, sipas dispozitës së nenit 429 par.1 të KPK do të ishte “premtim” ose “dhënie” e parave, e që po ashtu nuk është vërtetuar se ka ndodhur. Posaçërisht nuk mund të aprovohet pretendimi në kërkesë se i pandehuri S.M jo vetëm se e ka ditur por edhe i ka pranuar këto të holla, sepse kjo jo vetëm se nuk është vërtetuar por i pandehuri S.M nuk ka qenë i akuzuar për veprën penale të marrjes së ryshfetit.

Nga sa u tha, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në këtë pjesë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK, u vendos si në pikën 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.12/2021, më datë 26.07.2021

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi